

UDHËZIM
Nr. 2127/4, datë 7.7.2014

PËR ADMINISTRIMIN E AEROPORTIT TE KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 7.6.2006 “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Deri në vënien në punë të aeroportit të Kukësit, Autoriteti i Aviacionit Civil (person juridik publik, jobuxhetor) të përballojë shpenzimet e administrimit të tij nga fondet e veta të programuara.
2. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të evidentojë, në pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet, shpenzimet faktike të kryera për konservim, si shpenzimet për ruajtjen e objektit me rojë private, pagat, sigurimet shoqërore, detyrimet tatimore, faturat për blerje e shërbime të kryera nga të tretë etj.
3. Udhëzimi nr. 5, datë 17.4.2007 “Për përdorimin e fondeve të investimeve buxhetore për konservimin e aeroportit të Kukësit shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani